

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Eksperti i sigurisë: Veriu mbetet i brishtë, Serbia po tenton të krijojë situata artificiale në Kosovë
ADRESA	https://indeksonline.net/eksperti-i-sigurise-veriu-mbetet-i-brishte-serbia-po-tenton-te-krijoje-situata-artificiale-ne-kosove/
BURIMI	indeksonline.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	5 shtator 2026, 23:49:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 shtator 2026, 11:24:15 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d22b9a8e88095df496b90b5ee73a9e3700288cf07c9a32874936d4d848fec5e
TEKSTI	822fc8eb35c607ec9841a813cdd63fb64c443fe910c9e2c3850ca67ff697690e
PAMJA	4c5e6b229ac0d1514e83982f870a69e98e63a00e320f3f1a8c7b644f6aa3e6ab

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d0d9d0640804b963bcf30edb8d7dfe6b2203367be3ef494b5890c26159789cca
E MËPARSHMJA	2b2ae48e738817d85a161b6f7e28a4c78b9d32a147bc05e79da62e153983b19c
RRËNJA MERKLE	00a00f473eee6089e629c3fbe5b781cecb40006581d22ebdfab6238166e5deac
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d0d9d0640804b963bcf30edb8d7dfe6b2203367be3ef494b5890c26159789cca>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Ballina](#)
- [Lajme](#)
- [Sport](#)
- [Showbiz](#)
- [Tech](#)
- [Auto](#)
- [Kuriozitete](#)
- [Indeks+](#)
- [Ekonomi](#)
- [Shëndetësi](#)
- [Zgjedhjet](#)
- [Opinion](#)



Kërko produktin...






SHPËRNDAJE

13:24 / E Shtunë, 05 Shtator 2026 / B.XH

Ekspteri i sigurisë: Veriu mbetet i brishtë, Serbia po tenton të krijojë situata artificiale në Kosovë



Veriu i Kosovës vazhdon të zbulojë gjurmë të një të kaluare të armatosur. Gjetja e arsenalëve të armëve dhe bazave të përdorura nga strukturat paralele po ngre pikëpyetje të reja për nivelin e sigurisë në këtë pjesë të vendit dhe për rrezikun që mund të paraqesin ato edhe në të ardhmen.

Ekspteri i sigurisë, Drizan Shala në një prononcim për Ekonomia Online ka deklaruar se gjetja e vazhdueshme e armatimeve dhe bazave të përdorura më herët nga strukturat paralele të Milan Radoiqiçit dhe Serbia në pjesën veriore të Kosovës, tregon për një situatë të brishtë të sigurisë në këtë pjesë të vendit.

“Sa i përket gjetjes së armatimeve dhe bazave të cilat kanë shërbyer në të kaluarën struktura paralele të Radoiqiç-it dhe shtetit të Serbisë, tanimë Policia e Kosovës dhe Inteligjenca kosovare, duke bashkërenduar veprimet e tyre operative dhe duke komunikuar me qytetarët, kanë arritur që të lokalizojnë me dhjetëra baza të cilat janë shfrytëzuar nga këto struktura”, tha Shala.

Ai shtoi se gjetja e këtyre bazave dëshmon se situata në veri vazhdon të jetë e brishtë, ndërsa akuzoi Serbinë se po tenton të krijojë një situatë artificiale në këtë pjesë të Kosovës.

“Dhe njëherësh e dëshmon faktin që pjesa veriore mbetet një situatë kaotike në kuptimin e veprimeve që Serbia në mënyrë sistematike tenton ta krijojë si një situatë të re, artificialisht të krijuar nga ana e tyre si ngjarje në pjesën veriore, janë veprime që janë duke shtyrë serbët të largohen nga territori i Republikës së Kosovës me veprimet policore. Prandaj, shteti i Kosovës ka dëshmuar në këtë aspekt profesionalizmin e tyre dhe kjo si rezultat ka ngritur nivelin e bashkëpunimit edhe me faktorin ndërkombëtar, duke i marrë përgjegjësitë e reja nga vetë KFOR-i për pjesën veriore jo vetëm të çështja e urës, por edhe të çështja e brezit kufitar dhe veprime të tjera”, tha Shala.

Sipas tij, siguria në veri lidhet edhe me nivelin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Kosovës, shkëmbimin e informacioneve dhe rrezikun që, sipas tij, vazhdon të vijë nga Serbia.

“Dhe kjo mund ta përkufizojmë me një element esencial: profesionalizmi, veprimet profesionale, njëkohësisht shkëmbimi i informacioneve, por edhe rreziku permanent që është nga pala serbe, sepse ne e dimë që Serbia ka një doktrinë të cilën tanimë e ka adaptu nga pjesa ruse. Sepse në të kaluarën ju e dini fare mirë që vendet e Evropës tanimë janë në atak të drejtpërdrejtë nga dronët e ndryshëm. Madje edhe Gjermania ditët e fundit ka ftuar një konferencë për media dhe ka dëshmuar sulmin mbi infrastrukturën kritike, ku si rezultat i saj, jozyrtarisht ka ftuar ambasadorin gjerman për t’i dhënë një notë verbale”, deklaroi eksperti i sigurisë për Ekonomia Online.

Shala paralajmëroi se veprime të ngjashme me ato që po vërehen në Evropë mund të përdoren edhe ndaj Kosovës dhe vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, duke e lidhur këtë me procesin e militarizimit të Serbisë.

“Dhe gjitha këto veprime që ne i shohim në aspektin evropian, ne domosdo Serbia do t’i përdorë edhe ndaj Republikës së Kosovës edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, sepse militarizimi ushtarak që është duke ndodhur nga ana e Serbisë e dëshmon faktin që është duke u përgatitur për një situatë më të favorshme në kohë që ajo pastaj të veprojë. Prandaj, sulmet, vëzhgimet përmes dronëve, edhe Kosova mund të përballlet ashtu siç është përballur në të kaluarën nga veprimet që vijnë nga ana e palës serbe”, tha Shala.

Armë të llojeve të ndryshme, uniforma e pajise të tjera ushtarake u ekspozuan në Mitrovicë më 20 gusht të këtij viti.

Autoritetet thanë se ato u sekuestruan gjatë operacioneve të kryera në veri të vendit dhe në afërsi të lokacioneve ku janë gjetur mbetje mortore që dyshohet se u përkasin viktimave të luftës së fundit në Kosovë.

Mos i humb

- [Një veturë e FSK-së përfshihet në një aksident trafiku në kryeqytet \(Foto\)](#)



- [“Ndryshoi jetën time”, ushtari i KFOR-it kujton momentin e hyrjes në Kosovë 25 vjet më parë](#)



- [“I ke 30 minuta... Koha po kalon, kanë mbetur dhe 28 minuta”/ Kush është komandanti gjerman, që i dëboi nga Prizreni ushtarët serbë?](#)



- [Shoferi i duhur gjëbëtet 2 herë ,brenda pak minutash, për tejkalim shpejtësie](#)

- [Hajdari: Roli i Avokatit të Popullit të mos involvohet në procedura gjyqësore](#)

- [AKB: Rreth 40 për qind të bizneseve s'c përdorin arkën fiskale në mënyrën e duhur](#)

- [Aksident i rëndë në autostradën “Ibrahim Rugova”, të lënduarve po iu ofrohet ndihma mjekësore](#)



Të fundit nga Lajme

- [00:05 / E Hënë, 07 Shtator](#)
[26-vjeçari plagoset me thikë në Tiranë](#)
- [23:25 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Një person me probleme shëndetësore u shkakton lëndime dy familjarëve, arrestohet nga policia](#)
- [23:13 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Tragjike në Rahovec: I mituri gjendet i plagosur me armë zjarri, mjekët konstatojnë vdekjen](#)
- [22:56 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Dyshohet se sulmuan kapitenin Besart Ahmeti, dy të dyshuarit janë djemtë e këtij polici](#)
- [22:28 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Gjendet pa shenja jete një person në Mitrovicë](#)
- [22:10 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Shqipëri, Ministria e Mbrojtjes: 20 vatra zjarri në vend, 11 mbeten aktive](#)



Portali Indeksonline u themelua nga një grup gazetarësh kosovarë në vitin 2010. Përball sfidave të gazetarisë bashkëkohore, të motivuar nga nevoja për lajme të shpejta dhe origjinale, në Kosovë, ndër shqiptarë dhe për shqiptarët – Indeksonline nuk ishte veçse një kërkesë e kohës.

Materialet dhe informacionet mund të kopjohen, të shtypen dhe të përdoren por vetëm pas referimit të qartë të burimit të Portalit Indeksonline, në përputhje me kushtet e përdorimit.!!

© 2010 - 2026 Portali Indeksonline. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.